



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

Nr. 2358 prot

Tiranë, më 08.08.2022

Lënda: Kërkesë për ndryshimin e emrit të administratorit

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Me Vendimin nr. 22, datë 27.07.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera është vendosur sekuestrimi i shoqërisë së më poshtme:

1. Shoqëria "FORALB ALABASTER" shpk, me nr NIPT-i J629038441
2. Shoqëria "XYZ 08" shpk, me nr NIPT-i K 92110004 Q.
3. Shoqëria "GARDEN RESIDENCE TURDIU" shpk, me nr NIPT-i L91425024V ".

Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar, ligjit nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara" i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 22, datë 27.07.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka dalë urdhri nr. 2276, datë 02.08.2022 i Kryeadministratorit i cili cakton që për administrimin e pasurisë së sipër cituara ngarkohet administratori i agjencisë **Z. Arjan Baci**. Për sa më sipër kërkojmë:

- Ndryshimin e administratorit të shoqërisë "FORALB ALABASTER" shpk, me nr NIPT-i J629038441 duke vendosur administratorin e agjencisë z. Arjan Baci.
- Ndryshimin e administratorit të shoqërisë "GARDEN RESIDENCE TURDIU" shpk, me nr NIPT-i L91425024V " duke vendosur administratorin e agjencisë z. Arjan Baci.
- Ndryshimin e administratorit të shoqërisë "XYZ 08" shpk, me nr NIPT-i K 92110004 Q duke vendosur administratorin e agjencisë z. Arjan Baci.

Bashkangjitur do gjeni kopjen e vendimit nr. 22, datë 01.08.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe Urdhrin nr. 2276 Prot, date 02.08.2022 të Kryeadministratorit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYEADMINISTRATOR

Adrian KONI



  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Nr. 22 Akti  
Datë 26.07.2022

Nr.22 Vendimi  
Datë Vendimi: 27.07.2022

**VENDIM**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e përbërë nga:

**GJYQTARE: IRENA GJOKA**

Asistuar nga sekretare seance **Elsa LITA**, sot në datë 27.07.2022, ora 09:30, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, kërkesën penale Nr.22 Regjistri, me palë:

**KËRKUES:** Prokuroria e Posaçme Kundër Kurrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar në paraqitjen e kërkesës, nga prokurorët **Vladimir Mara dhe Dritan Prenci**.

**OBJEKTI:** Sekuestrimi i pasurive në zotërim të shtetasit Anton (Pashuk) **GJINAJ** (Gjini), i biri i Ndue dhe i Prendë, i datëlindjes 08.04.1966, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër personal ID G604080411.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (i ndryshuar).

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet e paraqitura, në dhomë këshillimi, bazuar në nenet 112 të Kodit Penal, nenet 3/1/a; 3/3,4; 5; 7; 11/1/a, 12, 14, 15 e vijues të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar me ligjin Nr.85/2020; Si dhe pasi e vlerësoi kërkesën në tërësi;

**VËREN SE:**

Më datë 26.07.2022, në sekretarinë e kësaj Gjykate është depozituar për gjykim kërkesa me kërkuës Prokuroria e Posaçme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar me objekt “Sekuestrimi i pasurive në zotërim të shtetasit Anton (Pashuk) **GJINAJ** (Gjini), i biri i Ndue dhe i Prendë, i datëlindjes 08.04.1966, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër personal ID G604080411”.



Në përputhje me kërkesat e nenit 12 paragrafi i parë të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, Endryshuar me ligjin Nr.85, viti 2020, kjo gjykatë në dhomë këshillimi, brenda afatit 5 ditor mori në shqyrtim kërkesën e prokurorit.

**Rrethanat e çështjes dhe provat e paraqitura nga prokuroria në mbështetje të kërkesës për sekuestrim pasurie.**

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr.7, datë 26.05.2021, në ngarkim të shtetasit Anton (Pashuk) GJINAJ (Gjini), i biri i Ndue dhe i Prendë, i datëlindjes 08.04.1966, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër personal ID G604080411.

Nga aktet e administruara rezultojnë se me vendimin Nr.9 të vitit 2010, të Gjykatës Provinciale të Alicante, me seli në Elce, Spanjë është deklaruar fajtor i pandehuri Pashuk Gjini dhe është dënua me 8 vjet e 9 muaj burgim për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Po kështu, rezultojnë se shtetasi Pashuk Gjini në muajin Qershor të vitit 2006 në bashkëpunim me pjestarë të tjerë të grupit kriminal, shtetasit Eduart Shehi, Matijas Fernandez, Maxim Antonov, Roy Evans, Edëin Dubbelman, Piefer Cornels dhe persona të tjerë të paidentifikuar, kanë trafikuar në Spanjë një sasi prej 50 kg e 610 gram lëndë narkotike të lloit "heroinë", me një vlerë tregu prej 1 941 623 Euro. Nga verifikimet e kryera nga ana e policisë gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithëshme të Policisë së Shtetit rezultojnë se shtetasi Pashuk Gjini me datë 17.02.2011, ka bërë ndërrimin e emrit nga "Pashuk Gjini" në "Anton Gjinaj".

Sipas prokurorisë, nga analiza e fakteve dhe e dokumentacionit të administruar përse i përket pasurive të shtetasit Anton (Pashuk) GJINAJ (Gjini), i biri i Ndue dhe i Prendë, i datëlindjes 08.04.1966, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër personal ID G604080411 dhe familjarëve të tij, rezultojnë se kanë një nivel të pajustificuar ekonomik dhe dyshohet se këto pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, t'i kenë fituar si rezultat i veprimtarisë së tij kriminale që ai ka zhvilluar në Shqipëri dhe Spanjë.

Nga verifikimet dhe të dhënat e grumbulluara në kuadër të hetimit pasuror, rezultojnë se:

Nga verifikimi i kryer në faqen on-line të QKB-së rezultojnë se shtetasi Anton Gjinaj posedon apo është aksioner në shoqëritë e mëposhtëme:

**1. Shoqëria "ALESIO – 2014" shpk**, me NIPT Nr.L41713003M, me datë themelimi 08.05.2014 dhe datë regjistrimi 13.05.2014, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Njësia Administrative Nr.11, Bulevardi "Lord Bajron", banesë private Nr.14, Tiranë, me kapital 30 100 000 lekë, me objekt të aktivitetit: "*Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, linjave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitesore, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinerike, portet, aeroportet objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike*; 2. *Ne fushen e tregetise shoqeria do te kryeje: Tregtimin dhe import-eksportin me shumice e pakice, te te gjitha mallrave me ose pa akcize, duke perfshire*



por pa u kufizuar ne industriale, ushqimore, mjekesore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake, te ndertimit (hidrosanitare, elektrike, mobileri), te mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, te makinerive, te te gjitha mineraleve, te lendes drusore, te lendeve te para dhe te 2 perpunuara per procesin e prodhimit; tregtimin e pasurive te luajtshme e te paluajtshme shitblerjen e tokes, tregtimin e mallrave te gatshme e gjysem te gatshme; etj; tregtimin me pakice te naftes, gazit natyror dhe nenprodukteve te tyre; ushtrimi i aktivitetit te bar- bufe-restorant, dhe njesive te tjera te tregtimit te pijeve alkolike dhe produkteve ushqimore te gatshme dhe gjysem te gatshme. Shitje-Blerje te objekteve, godinave, apartamenteve dhe cdo pasuri tjeter e paluajtshme. 3. Ne fushen e minierave shoqeria do te kryeje: Studimin, zbulimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te minierave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytezimin e minierave publike dhe private per te tera llojet e mineraleve, shfrytezimin e burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda dhe jashte vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara. 4. Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave brenda dhe jashte territorit te vendit si dhe tranzitimin e tyre pergjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujqor, teleferik etj. 5. Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere, per realizimin e hotelesise, fshatrave turistike, qendra turistike e te tjera dhe krijimin e faciliteve dhe aksesoreve te nevojshem, si bar bufe- restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi te shitjeve te konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industriale e te tjera te kesaj natyre; Krijimin e agjencive turistike e te tjera. 6. Ne fushen e Energjise shoqeria do te kryeje aktivitetin ne te gjitha burimet e mundshme te energjise (hidro, ure, qymyr, karburante etj) per prodhimin e energjise. Ndertimin dhe operimin e hidrocentraleve, TEC-eve, stacioneve elektrike, nenstacioneve elektrike, linjave te transmetimit te energjise, dhe strukturave te tjera ndihmese; Ndertimin, instalimin dhe perdorimin e njesive te prodhimit te energjise elektrike, dhe 3 prodhimin, transmetimin dhe shperndarjen e energjise elektrike. Furnizimin dhe tregtine e energjise elektrike te cdo forme, eksportin e energjise elektrike jashte territorit te Republikes se Shqiperise (lidhja nderkombetare), dhe importin e energjise elektrike brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Shoqeria do te kryeje cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per te favorizuar ate. Menaxhimi i mbetjeve te parrezikshme. Prodhimin dhe tregtimin e materialeve te ndryshme te ndertimit duke perfshire por jo u kufizuar tek produkti i asfaltit, betonit dhe inerteve te te gjitha llojeve. Sherbimin e Kateringut. Veprimtari financiare ne kembime valutore ", me administrator te shoqerise shtetasen Klaudia Gjini, me ortak te vetem shtetasin Anton Gjinaj, vlera e kapitalit 30 100 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100, me status "Aktiv".

2. Shoqëria "DEIZI - M" shpk, me NIPT Nr.L82212004G, me datë themelimi 22.09.2018 dhe datë regjistrimi 12.10.2018, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Njësia Administrative Nr.2, Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Galeria "ETC", Hyrja B, Tiranë, me kapital 10 000 000 lekë, me objekt të aktivitetit: "-Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, linjave mbitokësore dhe



nantokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujëse, centrale, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike; 2. Në fushën e tregëtisë shoqëria do të kryejë: Tregëtimin dhe import-eksportin me shumicë e pakicë, të të gjitha mallrave me ose pa akcizë, duke përfshirë por pa u kufizuar në industriale, ushqimore, mjekësore, bujqësore, blegtorale, elektroshtepiake, ndërtimit (hidrosanitare, elektrike, mobileri), të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinërive, të të gjitha mineraleve, të lëndës drusore, të lëndëve të para dhe të 2 përpunuara për procesin e prodhimit; tregëtimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme shitblerjen e tokës, tregëtimin e mallrave të gatshme e gjysem të gatshme, etj; tregëtimin me pakicë të naftës, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre; ushtrimi i aktivitetit të bar- buse-restorant, dhe njesive të tjera të tregëtimit të pijeve alkoolike dhe produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysem të gatshme. Shitje-Blerje të objekteve, godinave, apartamenteve dhe çdo pasuri tjetër e paluajtshme. 3. Në fushën e minierave investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të minierave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndërtimin dhe shfrytëzimin e minierave publike dhe private për të tëra llojet e mineraleve, shfrytëzimin e burimeve natyrore të ujërave minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, përpunimi dhe tregëtimi brenda dhe jashtë vendit e mineraleve të papërpunuara dhe të përpunuara. 4. Në fushën e transportit, shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukurës dhe/ose të pjesëve perberëse të saj, për transportimin publik dhe/ose privat të njerezve dhe mallrave brenda dhe jashtë territorit të vendit si dhe tranzitimin e tyre përgjatë territorit të Shqipërisë nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. 5. Në fushën e turizmit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukurës dhe/ose të pjesëve perberëse të saj, për shfrytëzimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, të burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, të Shqipërisë dhe me gjere, për realizimin e hotelerisë, fshatrave turistike, qendra turistike e të tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve të nevojshëm, si bar buse- restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi të shitjeve të konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industriale e të tjera të kësaj natyre; Krijimin e agjencive turistike e të tjera. 6. Në fushën e Energjisë shoqëria do të kryejë aktivitetin në të gjitha burimet e mundshme të energjisë (hidro, ure, qymyr, karburante etj) për prodhimin e energjisë. Ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve, TEC-eve, stacioneve elektrike, nënstacioneve elektrike, linjave të transmetimit të energjisë, dhe strukturave të tjera ndihmëse; Ndërtimin, instalimin dhe përdorimin e njesive të prodhimit të energjisë elektrike, dhe 3 prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Furnizimin dhe tregëtimin e energjisë elektrike të çdo forme, eksportin e energjisë elektrike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (lidhja nderkombetare), dhe importin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria do të kryejë çdo lloj aktiviteti në raport me objektin dhe për të favorizuar atë. Menaxhimi i mbetjeve të parrezikshme”, me likuidator të shoqërisë shtetasin Elton Pjetri, me ortak të vetëm shtetasin Anton Gjinaj, vlera e kapitalit 10 000 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100, me status “Shoqëri në likuidim e sipër”.

**3. Shoqëria “POLYSTYRENE (EPS) MANUFACTURER” shpk, me NIPT Nr.L81811014B,** me datë themelimi 04.06.2018 dhe datë regjistrimi 11.06.2018, me formë ligjore të shoqërisë “Shpk”, me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Fshati Ahmetaq, Fushë-Prezë, Tiranë, me kapital 100 000 lekë, me objekt të aktivitetit: “Hapjen e fabrikave për prodhimin e polisterolit. Hapjen e fabrikave për prodhimin e depozitave plastike. Hapjen e magazinave me shumicë apo



*pakice per shitjen dhe magazinimin e tyre. Import te lendes se pare per prodhimin e polisterolit. Import te lendes se pare per prodhimin e depozitave plastike. Import - eksport, dhe shitje me shumice e pakice i mallrave te ndryshem", me administrator te shoqërisë shtetasin Anton Gjinaj, me ortak të vetëm shtetasin Anton Gjinaj, vlera e kapitalit 100 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100, me status "Pezullur".*

**4. Shoqëria "FORALB ALABASTER" shpk**, me NIPT Nr. J62903844I, me datë themelimi 04.11.1994 dhe datë regjistrimi 08.11.1994, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Mengaj, Kavajë, me kapital 30 980 000 lekë, me objekt të aktivitetit: *" Prodhimin dhe ekspertimin e gips-alabaster dhe prodhimeve te tyre, tregtimi i tyre per vend dhe eksport. Nxjerrja, shfrytëzimi dhe përpunimi i produkteve të alabastres, gips dhe materialeve të tjera jo metalore, prodhimin e tregtimin me pakicë e shumicë te prodhimeve të ndryshme prej druri, eksport-import te materialeve te ndryshme, artikujve te ndryshem industriale, etj. Veprimtari dhe shërbime të tjera të lejuara nga ligji", me administrator të shoqërisë shtetasin Anton Gjinaj, me ortak shoqërinë "ALESIO 2014" shpk, vlera e kapitalit 23 232 000 lekë, numri i pjesëve 23 232, pjesëmarrja në përqindje 74.99% dhe ortak tjetër Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, vlera e kapitalit 7 746 000 lekë, numri i pjesëve 7 746, pjesëmarrja në përqindje 25%, me status "Aktiv".*

**5. Shoqëria "XYZ 08" shpk**, me NIPT Nr. K92110004Q, me datë themelimi 18.02.2008 dhe datë regjistrimi 10.09.2008, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Njësia Administrative Nr.11, Bulevardi "Lord Bajron", banesë private Nr.14, Tiranë, me kapital 100 000 lekë, me objekt të aktivitetit: *"Ne fushen e minierave shoqëria do te kryeje: Studimin, zbulimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te minierave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytezimin e minierave publike dhe private per te tera llojet e mineraleve, shfrytezimin e burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, përpunimi dhe tregtimi brenda dhe jashte vendit e mineraleve te papërpunuara dhe te përpunuara. Prodhim dhe tregtim materiale inerte guri. Prodhim dhe tregtim elemente betoni e betonarme te zakonshme te pararendur - gure dekorative. Prodhim dhe tregtim materiale lidhes gelqere, allci cemento. Prodhim dhe tregtim i te gjithe materialeve te nevojshme ne fushen e ndertimit. Shit-blerja e pasurive te paluajtshme, godinave , apartamenteve dhe cdo pasurie tjeter e paluajtshme", me administrator të shoqërisë shtetasin Elton Pjetri, me ortak shoqërinë "ALESIO 2014" shpk, vlera e kapitalit 100 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100%, me status "Aktiv".*

**6. Shoqëria "GARDEN RESIDENCE TURDIU" shpk**, me NIPT Nr. L91425024V, me datë themelimi 21.02.2019 dhe datë regjistrimi 25.02.2019, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Rruga e "Durrësit" (zona e ish-fushës së aviacionit), Pasuria Nr. 1/284, Vol.13, Fq.42, ZK8210, Tiranë, me kapital 1 000 000 lekë, me objekt të aktivitetit: *" Investimin ne Fazen e III dhe te IV te punimeve/ndertimeve me qellim zhvillimin, ndertimin, administrimin dhe shitjen e nje godine multifunkionale me parkime, dyqane, zyra dhe apartamente, si nje Projekt i Shoqërisë "KASTRATI" SHA dhe "A.K" shpk, me vendndodhje ne Tirane, "Rruga e Durrësit" (zona e ish-fushes se Aviacionit), mbi pasurine nr. 1/284 Volum 13, faqe 42, Zona Kadastrale 8210. ("Projekti"). Ndertim, Projektim, Konsulencë, sipermarrje zbatuese dhe/ose investim, sipas rastit. Import-eksport i te gjithe llojeve te materialeve dhe makinerive te ndertimit. Ndertim, permiresim, mirembajtje te rrugeve, autostradave, mbikalimeve, mbikalimeve, urave, tuneleve, porteve, aeroportëve, digave, hidrocentraleve dhe veprave te tjera te infrastruktures, si dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjeter te nevojshem, ndihmes apo plotesues."*



*funkcion te objektit kryesor te shoqerise", me administrator te shoqerise shtetasen Klaudia Gjini, me ortak shoqerine "ALESIO 2014" shpk, vlere e kapitalit 1 000 000 lekë, numëri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100%, me status "Aktiv".*

Nga verifikimi i kryer rezulton se në emër të familjarëve të shtetasit Anton Gjinaj dhe shoqërive të tij figurojnë të regjistruara pasuritë e mëposhtëme:

**Radusha Seferin Gjini (bashkëshortja):**

- Pasuri Nr.10/587, Vol.39, Faq.138, ZK Nr.8310, me sipërfaqe totale 1 290 m2, e llojit truall nga e cila 246 m2 ndërtesë, me adresë Rruga "Gjergj Legisi", Tiranë.
- Pasuri Nr.10/303+1-12, Vol.17, Faq.156, ZK Nr.8310, me sipërfaqe totale 120 m2, e apartament, me adresë, Laprakë, Tiranë.

**Pavlin Viktor Kola (bashkëshorti i vajzës):**

- Pasuri Nr.1/357, Vol.19, Faq.176, ZK Nr.8260, me sipërfaqe totale 301.5 m2, e llojit truall nga e cila 246 m2 ndërtesë, me adresë Rruga "Irfan Tomini", Tiranë.

**Shoqëria "ALESIO – 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M**

- Pasuri Nr.25/32, Vol.14, Faq.61, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 1 680 m2, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, blerë në shumën 4 000 000 lekë.
- Pasuri Nr.25/30, Vol.14, Faq.1, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 6 530 m2, e llojit arë, me adresë Rruga "Fadil Rada", Tiranë, blerë në shumën 42 000 000 lekë.
- Pasuri Nr.25/28, Vol.13, Faq.249, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 5 560 m2, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, blerë në shumën 22 750 000 lekë.
- Pasuri Nr.25/23, Vol.13, Faq.186, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 3 930 m2, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë.
- Pasuri Nr.25/33, Vol.14, Faq.62, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 1 670 m2, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë.
- Pasuri Nr.3/283, Vol.18, Faq.40ZK Nr.8180, me sipërfaqe totale 480 m2, e llojit truall, me adresë Tiranë, blerë në shumën 13 245 000 lekë.
- Pasuri Nr.3/283-ND, Vol.37, Faq.27, ZK Nr.8180, me sipërfaqe totale 84.4 m2, e llojit ndërtesë, me adresë Tiranë.
- Pasuri Nr.3/169-ND, Vol.37, Faq.46, ZK Nr.8180, me sipërfaqe totale 57.8 m2, e llojit ndërtesë, me adresë Tiranë.
- Pasuri Nr.598/47, Vol.11, Faq.156, ZK Nr.2529, me sipërfaqe totale 2 092.4 m2, e llojit truall, me adresë Lundër, Tiranë, blerë në shumën 1 157 000 euro.
- Pasuri Nr.21/17, Vol.17, Faq.168, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 700 m2, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, blerë në shumën 1 157 000 euro.

**1.Shtetasi Anton Gjinaj, ka poseduar automjetet e regjistruar në emër të tij dhe konkretisht:Automjet i tipit autoveturë, e markës "Mercedes-Benz", modeli CLS320CDI, me targa TR 5545 T, me numër shasie EDD2193221A113273. Ky automjet figuron në emër të shtetasit Fadil Selman Murati.**

**2.Shtetësja Radusha Gjini, posedon automjetin e regjistruar në emër të saj dhe konkretisht: Automjet i tipit autoveturë, e markës "Mercedes-Benz", modeli G 63 AMG, me targa AA 006 YZ, me numër shasie EDB4632761X327336.**



3. Shtetësja **Klaudia Gjini**, posedon automjetin e regjistruar në emër të saj dhe konkretisht: Automjet i tipit autoveturë, e markës "Mercedes-Benz", modeli GLE 400 d 4MATIC Coupe, me targa AB 006 HE, me numër shasie E1N1673231A160131.

4. Shtetasi **Pavlin Kola**, posedon automjetin e regjistruar në emër të tij dhe konkretisht: Automjet i tipit autoveturë, e markës "VOLKSEAGEN", modeli "GOLF", me targa AA 470 JS, me numër shasie E V E Z Z Z 1 K Z B E 006182.

Nga verifikimet dhe analizat financiare të kryera rezultojnë se të ardhurat e ligjshme të shtetasit Anton (Pashuk) Ndue Gjinaj (Gjini) dhe familjareve të tij rezultojnë si më poshtë :

1. Shtetasi Pashuk Ndue Gjinaj për periudhën Maj 2014 deri në muajin Prill 2022 ka deklaruar pranë ISSH, paga për kontribut bruto gjithsej në shumën 19 716 738 Leke (pa hequr pagesat për sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore dhe taksa të tjera). Këto pagesa janë derdhur nga shoqëria "Alesio 2014" me NIPT L41713003M e cila është shoqëria e tij. Rezultojnë se pagat me të larta për këtë shtetas janë kryer vetëm 2-3 vitet e fundit, pasi më parë ka deklaruar paga të ulta apo mesatare.

2. Shtetësja Radusha Seferin Gjini (bashkëshortja) për periudhën Prill 2012 deri Korrik 2014 nuk ka deklaruar paga mujore. Ndërsa për periudhën Korrik 2014 deri deri në muajin Prill 2022 ka deklaruar pranë ISSH, paga për kontribut bruto gjithsej në shumën 15 035 355 Lekë (pa hequr pagesat për sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore dhe taksa të tjera). Këto pagesa janë derdhur nga shoqëria "Alesio 2014", me NIPT L41713003M e cila është shoqëria e bashkëshortit të saj Anton Gjinaj. Rezultojnë se pagat me të larta për këtë shtetas janë kryer vetëm 2-3 vitet e fundit, pasi më parë ka deklaruar paga të ulta apo mesatare.

3. Shtetësja Vanesa Anton Gjini (vajza e Anton Gjinaj), për periudhën Nëntor 2020 deri deri në muajin Tetor 2021 ka deklaruar pranë ISSH, paga për kontribut bruto gjithsej në shumën 426 154 Leke (pa hequr pagesat për sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore dhe taksa të tjera). Këto pagesa janë derdhur nga shoqëria "Alesio 2014", me NIPT L41713003M e cila është shoqëria e babait të saj Anton Gjinaj.

4. Shtetasi Alesio Anton Gjini (djali i shtetasit Anton Gjinaj), nuk ka të deklaruar pagesa mujore për asnjë periudhë kohe.

5. Shtetësja Klaudia Anton Gjini (vajza e Anton Gjinaj), për periudhën Shtator 2014 deri në muajin Prill 2022 ka deklaruar pranë ISSH, paga për kontribut bruto gjithsej në shumën 6 198 189 Leke (pa hequr pagesat për sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore dhe taksa të tjera). Këto pagesa janë derdhur nga shoqëria "Alesio 2014", me NIPT L41713003M e cila është shoqëria e babait të saj Anton Gjinaj. Rezultojnë se pagat me të larta për këtë shtetas janë kryer vetëm 2-3 vitet e fundit, pasi më parë ka deklaruar paga të ulta apo mesatare.

6. Shtetasi Pavlin Viktor Kola (bashkëshorti i vajzës së Anton Gjinaj), për periudhën Dhjetor 2012 deri në vitin 2014 dhe nga Maj 2014 dhe deri deri në muajin Prill 2022 ka deklaruar pranë ISSH, paga për kontribut bruto gjithsej në shumën 5 812 957 Leke (pa hequr pagesat për sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore dhe taksa të tjera). Këto pagesa janë derdhur nga shoqëria "Alesio 2014", me NIPT L41713003M e cila është shoqëria e babait të bashkëshortes së tij Anton Gjinaj. Rezultojnë se pagat me të larta për këtë shtetas janë kryer vetëm 2-3 vitet e fundit, pasi më parë ka deklaruar paga të ulta apo mesatare.





Sipas prokurorisë, nga analiza e mësipërme rezultojnë se të gjithë këta persona të ardhurat me të larta i kanë patur 2-3 vitet e fundit, ndërkohë që pasuritë janë vendosur më parë dhe të ardhurat kanë qenë më të vogla në krahasim me vlerën e pasurive të tyre.

Pasuritë e përshkruara më sipër të shtetasit Anton Gjinaj dhe familjarëve të tij, dyshohet se janë vendosur nga të ardhurat e krijuara nga aktiviteti kriminal dhe bazuar në nenin 11 të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", nga ana e prokurorisë vlerësohet se duhet të vendoset sekuestro mbi këto pasuri.

Së pari, pasuritë e mësipërme janë pasuri që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi Anton Gjinaj është i përfshirë në veprimtarinë kriminale të veprës penale "Trafikimit të narkotikëve" dhe "Grupi i strukturuar kriminal" sipas legjislacionit penal Spanjoll, parashikuar njëkohësisht si veprë penale nga nenet 283/a dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si dhe pasuritë në fjalë janë krijuar gjatë përfshirjes së këtij shtetasi në veprimtarinë kriminale të mësipërme.

Së dyti, pasuritë e mësipërme, zotërohet nga shtetasi e sipërpërmendur si subjekt të ligjit dhe ekzistojnë prova konkrete se janë të pajustificuara. Duke u krahasuar vlera e tyre me të ardhurat e fituara në rrugë të ligjshme, rezultojnë se vlera e tyre nuk iu përgjigjet dukshëm nivelit të të ardhurave dhe të fitimeve të realizuara në rrugë të ligjshme.

Së treti, ka arsye të bazuara për të besuar se lidhur me pasuritë e mësipërme ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e saj tek persona të tjerë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e këtyre pasurive.

Për këto arsye, në bazë të neneve 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (i ndryshuar) nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kërkohet: Sekuestrimin e pasurive të sipërcituara. Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të mësipërme të ngarkohet Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

#### Vlerësimi i Gjykatës

Kjo gjykatë në analizë të akteve dhe provave të mësipërme, si dhe në vështrim të parashikimeve të neneve 3, 5, 6 e posaçërisht kriteret e përcaktuara në nenin 11-12 të ligjit parandalues Nr.10192 datë 03/12/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar me ligjin Nr.85/2020 vlerëson se, kërkesa është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

Neni 3 "Fusha e zbatimit" parashikon se:

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:



- a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;
- b) pjesëmarrje dhe kryerje e krimeve nga organizata terroriste dhe krimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;
- c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal;
- c) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;
- d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

- a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetësi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta;
- b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të njastueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

**Neni 11 "Kriteret për sekuestrim të pasurisë" parashikon se:**

1. Me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësi të plotë ose të pjesëshme të personave, sipas nenit 3, pika 1, të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura shpërpjesëtimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përlligjen prej tyre, si dhe kur:"

- a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose
- b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

2. Kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë përmban indiciet, në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm, si dhe arsyetimin për të paktën një prej kushteve të pikës 1 të këtij neni.

Qëllimi i masave kundër produkteve që rrjedhin nga aktivitete kriminale është që të sekuestrojë dhe konfiskojë ato produkte që rrjedhin nga aktivitete kriminale dhe që janë përfituar gjatë dhe për shkak të këtij aktiviteti kriminal dhe jo të sekuestrojë apo të konfiskojë pasuri të cilat kanë prejardhje të ligjshme. Ky qëllim shprehet qartë edhe në aktet ndërkombëtare. Kështu, konventa e OKB-së dhe ajo e Varshavës për sekuestrimin e produkteve, përcakton pasurinë kundrejt të cilës drejtohet sekuestrimi dhe konfiskimi. Konkretisht masat për ngrirjen, bllokimin dhe konfiskimin të përfshijnë:

- a) pasurinë, në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet;

<sup>1</sup> Për më shumë shiko, nenin 12 të Konventës së OKB-së kundër K.O me titull: "Konfiskimi dhe marrja e sendeve".



-b) pasurinë e përftuar nga burime të ligjshme, nëse fitimet janë përzier, pjesërisht ose tërësisht, me një pasuri të tillë, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përzier;  
c) të ardhurat ose privilegje të tjera që rrjedhin nga fitimet, nga pasuria në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet nga krimi, ose nga pasuria me të cilën janë përzier produktet nga krimi, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përzier, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë sa edhe fitimet.

Në nenin 3/1 të Konventës së Këshillit të Evropës përcaktohet se objekt sekuestrimi do të jetë vetëm ajo pjesë e pasurisë dhe të ardhurave, të cilat nuk justifikojnë mënyrën e fitimit dhe origjinën e ligjshme. Pra lejon "konfiskimin e sendeve dhe produkteve ose pasurive, vlera e të cilave u korrespondon këtyre produkteve". Pra mund të konfiskohet përfitimi direkt nga aktiviteti kriminal, por edhe ajo pjesë që është e përzier. Kufiri ligjor është vendosur në nenin 3 të ligjit pika 1 e Konventës së Varshavës në të cilin thuhet: "çdo shtet palë do të marrë ato masa për të lejuar konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve ose pasurive, vlera e të cilave u korrespondon këtyre produkteve".

Pra detyrimi ligjor që vë konventa është: "sekuestrimi vetëm i pasurisë që ka origjinë të paligjshme dhe që është produkt i veprave penale të parashikuara në Konventë", pra origjina e pasurisë është e lidhur me aktivitetet kriminale.

Masat me karakter pasuror si ajo e sekuestrimit dhe ajo e konfiskimit duhet të caktohen duke u individualizuar secila pasuri veçmas. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj Unifikues me nr.1, datë 25.01.2007 e cila përcakton se: "Masa e sekuestrimit apo e konfiskimit do të vendoset për secilën pasuri veçmas duke e individualizuar atë dhe duke provuar nëse është situar në mënyrë të ligjshme apo jo. Për këto pasuri nuk ekziston prezumimi se janë të gjitha të paligjshme kjo nuk përjashton mundësinë që të ketë pasuri të situar në mënyrë të ligjshme. Gjykata duhet të vërtetojë që ekziston një lidhje shkakësore midis pasurive të sekuestruara dhe veprimtarisë kriminale. Pasuritë nuk mund të sekuestrohen kur vërtetohet se kjo pasuri është situar në mënyrë të ligjshme dhe përpara se personi të kryente veprimtari kriminale."

Këto kufizime dhe kufij janë parashikuar edhe në ligjin Anti-mafia, qëllimi i të cilit është konfiskimi i pasurive që rrjedhin nga dhe gjatë aktivitetit kriminal për ato vepra penale të parashikuara në nenin 3, të cilat i kemi përmendur edhe më lart.

Së pari: Gjykata nga të dhënat më sipër arrin në konkluzion se, në bazë të nenit 3/1 gërma "c" e ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar, shtetasi Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini), është subjekt i ligjit parandalues, pasi në bazë të Vendimit nr.9 të vitit 2010, të Gjykatës Provinciale të Alicante, me seli në Elce, Spanjë ky shtetas është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 8 vjet e 9 muaj burgim për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se shtetasi Pashuk Gjini në muajin Qershor të vitit 2006 në bashkëpunim me pjestarë të tjerë të grupit kriminal, shtetasit Eduart Shehi, Matijas Fernadez, Maxim Antonov, Roy Evans, Edëin Dubbelman, Pieter Cornelis dhe persona të tjerë të paidentifikuar, kanë trafikuar në Spanjë një sasi prej 50 kg e 610 gram lëndë narkotike të lloit "heroinë", me një vlerë tregu prej 1 941 623 Euro. Nga sa sipër rezulton se subjekti nën hetim pasuroror Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini), është dënuar për fakte penale që parashikohen si vepra penale nga neni 283/a dhe 333/a të K.Penal, që në bazë të nenit 3/1, gërmat a) dhe c) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit. Referuar nenit 7 të Ligjit të mësipërm i cili parashikon se



"1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykatat e rrethëve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.", vepra penale e mësipërme, parashikuar përkatësisht nga neni 283/a dhe 333/a të K.Penal, është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e organizuar, referuar nenit 75/a të K.Pr.Penale.

**Së dyti:** Po ashtu ekziston së paku një prej kushteve të pikës 1, të nenit 11 të ligjit më sipër (neni 11/1 gërma a), pasi ka arsye të bazuara për të besuar se lidhur me pasuritë e luajtshme dhe paluajtshme të mësipërme objekt sekuestrimi, ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e tyre tek persona të tretë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e tyre.

Në përputhje sa më sipër, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje që tregon se subjekti nën hetim pasuror është i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura shpërpjesëtimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përlligjen prej tyre. Kështu nga verifikimet e kryera në kuadër të hetimit pasuror, ka rezultuar se ky shtetas pas përfshirjes në veprimtari kriminale në shtetin spanjoll, në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike (viti i përfshirjes: qershor 2006), ka nisur aktivitetin ekonomik në Shqipëri, duke themeluar një tërësi personash juridikë, ku personalisht gëzon cilësinë e ortakut apo administratorit dhe këtë cilësi e kanë në disa raste të afërm të tij, si dhe duke investuar në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në vlera të konsiderueshme. Po kështu, rezulton se pasuritë e shtetasit Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini) posedohen nga vetë shtetasi, familjarë të tij apo lidhje miqësore.

Sa më sipër, krijohet dyshimi i arsyeshëm se të ardhurat e përfituara nga aktiviteti kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike të llojit heroinë, në shtetin spanjoll, shtetasi Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini), i ka investuar në krijimin e personave juridikë nëpërmjet të cilëve ka mundur blerjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, në Shqipëri, në emrin e tij, familjarëve dhe lidhjeve të tij me interes.

Ka arsye të bazuara për të besuar se lidhur me pasuritë e luajtshme dhe paluajtshme të mësipërm ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e tyre tek persona të tretë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e tyre.

Në analizë sa sipër, mbi bazën e provave të marra e shqyrtuara në dhomë këshillimi, gjykata vlerëson se kërkesa e palës kërkuese për sekuestrimin e pasurive të evidentuara në pronësi të subjektit nën hetim pasuror Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini) dhe personave të tretë, është bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

**Së treti:** Jemi para kërkesave të nenit 3, pika 6 e Ligjit nr.10192 datë 03.12.2009<sup>2</sup>, pasi këto pasuri plotësojnë kriteret e parashikuara nga ky nen. Referuar datës së krijimit të tyre këto pasuri janë vënë pas përfshirjes së tij në veprimtari kriminale.

**Së katërti:** Referuar nenit 3, paragrafi 2, gërmat a) dhe b) të ligjit 10192, datë 03.12.2009<sup>3</sup>, i ndryshuar për pasuritë që figurojnë në emër të personave të afërm, bashkëshortja e tij Radusha Gjini, vajza e tij Klaudia Gjini, dhëndrri i tij Pavlin Kola dhe shtetasi Fadil Selman Murati, zbatohet

<sup>2</sup> 6.Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpura hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicje të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.

<sup>3</sup> 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga: a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijet, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesit), për të cilët presumesha regjistrimi i rrethit, përveçse kur provohet e kundërta; b) personat ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.



parimi i prezumimit të regjistrimit të rremë, përveçse kur provohet e kundërta. Në rastin konkret nga hetimet paraprake, ka dyshime se këta shtetas nuk kanë të ardhura të ligjshme për të mbuluar burimin e pasurive në emër të tyre.

Sa i përket barrës së provës, në procedimin parandalues, kemi një barrë prove që merr elementë të dy procedimeve, pasi fillon me nenin 4 të K.Pr. Penale, ku barrën e provës e ka prokurori, vazhdon dhe mbaron me nenin 8 dhe 12 të K.P.Civile, ku barrën e provës e ka personi i dyshuar në veprimtari kriminale. Pra barra e provës në procedimin parandalues transferohet nga organi i akuzës në fillim të procedimit parandalues dhe në vazhdim kalon tek personi i dyshuar për pjesëmarrje në veprimtari kriminale nga ato të parashikuara në nenin 3 të ligjit 10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar.

Pas kësaj faze, barra e provës kalon te personi i dyshuar për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për të argumentuar mungesën e udhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale ose investim të tyre.

Këtë qëndrim mban edhe Gjykata e Lartë Kolegjet e Bashkuara të saj në vendimin unifikues nr.1, date 25.01.2007, në lidhje me barrën e provës duke cituar se: "...Vendosja e masës pasurore ka në themel të saj mundësinë, dyshimin e arsyeshmë të mbështetur në të dhëna të njafshueshme që rezultojnë nga tërësia e provave të marra dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit të çështjes", ç'ka prezumon edhe paligjshmërinë e kësaj pasurie.

Ndryshe nga procedimi penal ku personi prezumohet i pafajshëm dhe barrën e provës e ka organi i akuzës, në procedimin parandalues ekziston prezumimi për zotërim dhe prejardhje të paligjshme të pasurisë e lidhur kjo me veprimtarinë kriminale të personit. Kjo është edhe arsyeja pse barra e provës zhvendoset nga organi i akuzës tek vet personi apo personat e tretë që kanë lidhje me të.

Në bazë të nenit 12/2 të ligjit të sipercituar masa e sekuestros është e ekzekutueshme me shpalljen e saj dhe është e vlefshme për një periudhë 6 mujore.

Në bazë të nenit 14/1 urdhërohet sekretaria gjyqësore të dërgojë pa vonesë dy kopje të vendimit, prokurorëve, të cilët duhet të marrin masat për vënien në ekzekutim të vendimit nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore dhe administratorit të pasurive.

Mbështetur në nenin 14/3 të ligjit Nr.10192 datë 03.09.2009, i ndryshuar, policia gjyqësore pas udhrit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori, procedon me marrjen e pasurisë dhe dorëzimin tek Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara edhe kur personat që preken nga masa kanë të drejta reale ose personale për t'i gëzuar ato.

Referuar nenit 14/4 e ligjit më sipër, policia gjyqësore u njofton masën e sekuestrimit të pasurive personave të interesuar, që kanë në zotërim apo pronësi pasuritë objekt sekuestrimit.

Në referim të nenit 15/1 të ligjit sipercituar, për administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet Z. Erald Todri, administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në Ministrinë e Financave, Tiranë.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nëneve 112 të K.Pr.Penale, nenet 3/1/a; 3/3,4; 5; 7; 11/1/a, 12,14,15 e vijues të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar me ligjin Nr.85/2020

VENDOSI



I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

II. Sekuestrimin e pasurive të subjektit nën hetim pasuror Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini), si dhe të personave të lidhur si më poshtë:

1. Shoqëria "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M, me datë themelimi 08.05.2014 dhe datë regjistrimi 19.05.2014, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Njësia Administrative Nr.11, Bulevardi "Lord Bajron", banesë private Nr.14, Tiranë, me kapital 30 100 000 lekë, me administrator të shoqërisë shtetasen Klaudia Gjini, me ortak të vetëm shtetasin Anton Gjinaj, vlera e kapitalit 30 100 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100, me status "Aktiv".
2. Shoqëria "DEIZI - M" shpk, me NIPT Nr.L82212004G, me datë themelimi 22.09.2018 dhe datë regjistrimi 12.10.2018, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Njësia Administrative Nr.2, Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Galeria "ETC", Hyrja B, Tiranë, me kapital 10 000 000 lekë, me likuidator të shoqërisë shtetasin Elton Pjetri, me ortak të vetëm shtetasin Anton Gjinaj, vlera e kapitalit 10 000 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100, me status "Shoqëri në likuidim e sipër".
3. Shoqëria "POLYSTYRENE (EPS) MANUFACTURER" shpk, me NIPT Nr.L81811014B, me datë themelimi 04.06.2018 dhe datë regjistrimi 11.06.2018, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Fashati Ahmetaq, Fushë-Prezë, Tiranë, me kapital 100 000 lekë, me administrator të shoqërisë shtetasin Anton Gjinaj, me ortak të vetëm shtetasin Anton Gjinaj, vlera e kapitalit 100 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100, me status "Pezulluar".
4. Shoqëria "FORALB ALABASTER" shpk, me NIPT Nr.J62903844I, me datë themelimi 04.11.1994 dhe datë regjistrimi 08.11.1994, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Mengaj, Kavajë, me kapital 30 980 000 lekë, me administrator të shoqërisë shtetasin Anton Gjinaj, me ortak shoqërinë "ALESIO 2014" shpk, vlera e kapitalit 23 232 000 lekë, numri i pjesëve 23 232, pjesëmarrja në përqindje 74.99% dhe ortak tjetër Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, vlera e kapitalit 7 746 000 lekë, numri i pjesëve 7 746, pjesëmarrja në përqindje 25%, me status "Aktiv".
5. Shoqëria "XYZ 08" shpk, me NIPT Nr.K92110004Q, me datë themelimi 18.02.2008 dhe datë regjistrimi 10.09.2008, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Njësia Administrative Nr.11, Bulevardi "Lord Bajron", banesë private Nr.14, Tiranë, me kapital 100 000 lekë, me administrator të shoqërisë shtetasin Elton Pjetri, me ortak shoqërinë "ALESIO 2014" shpk, vlera e kapitalit 100 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100%, me status "Aktiv".
6. Shoqëria "GARDEN RESIDENCE TURDIU" shpk, me NIPT Nr.L91425024V, me datë themelimi 21.02.2019 dhe datë regjistrimi 25.02.2019, me formë ligjore të shoqërisë "Shpk", me adresë të zyrës qendrore të shoqërisë në Shqipëri: Rruga e "Durrësit" (zona e ish-fushës së aviaacionit), Pasuria Nr.1/284, Vol.13, Fq.42, ZK8210, Tiranë, me kapital 1 000 000 lekë, me administrator të shoqërisë shtetasen Klaudia Gjini, me ortak shoqërinë "ALESIO 2014" shpk, vlera e kapitalit 1 000 000 lekë, numri i pjesëve 1, pjesëmarrja në përqindje 100%, me status "Aktiv".



7. Pasuri Nr.10/587, Vol.39, Faq.138, ZK Nr.8310, me sipërfaqe totale 1 290 m<sup>2</sup>, e llojit truall nga e cila 246 m<sup>2</sup> ndërtesë, me adresë Rruga "Gjergj Legisi", Tiranë, në emër të shtetases Radusha Seferin Gjini (bashkëshortja e subjektit nën hetim pasuror).
8. Pasuri Nr.10/303+1-12, Vol.17, Faq.156, ZK Nr.8310, me sipërfaqe totale 120 m<sup>2</sup>, e apartament, me adresë, Laprakë, Tiranë në emër të shtetases Radusha Seferin Gjini (bashkëshortja e subjektit nën hetim pasuror).
9. Pasuri Nr.1/357, Vol.19, Faq.176, ZK Nr.8260, me sipërfaqe totale 301.5 m<sup>2</sup>, e llojit truall nga e cila 246 m<sup>2</sup> ndërtesë, me adresë Rruga "Irfan Tomini", Tiranë në emër të shtetasit Pavlin Viktor Kola, (bashkëshorti i shtetases Klaudia Gjini, vajza e subjektit nën hetim pasuror).
10. Pasuri Nr.25/32, Vol.14, Faq.61, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 1 680 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, blerë në shumën 4 000 000 lekë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
11. Pasuri Nr.25/30, Vol.14, Faq.1, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 6 530 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Rruga "Fadil Rada", Tiranë, blerë në shumën 42 000 000 lekë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
12. Pasuri Nr.25/28, Vol.13, Faq.249, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 5 560 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, blerë në shumën 22 750 000 lekë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
13. Pasuri Nr.25/23, Vol.13, Faq.186, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 3 930 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
14. Pasuri Nr.25/33, Vol.14, Faq.62, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 1 670 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
15. Pasuri Nr.3/283, Vol.18, Faq.40, ZK Nr.8180, me sipërfaqe totale 480 m<sup>2</sup>, e llojit truall, me adresë Tiranë, blerë në shumën 13 245 000 lekë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
16. Pasuri Nr.3/283-ND, Vol.37, Faq.27, ZK Nr.8180, me sipërfaqe totale 84.4 m<sup>2</sup>, e llojit ndërtesë, me adresë Tiranë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
17. Pasuri Nr.3/169-ND, Vol.37, Faq.46, ZK Nr.8180, me sipërfaqe totale 57.8 m<sup>2</sup>, e llojit ndërtesë, me adresë Tiranë, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
18. Pasuri Nr.598/47, Vol.11, Faq.156, ZK Nr.2529, me sipërfaqe totale 2 092.4 m<sup>2</sup>, e llojit truall, me adresë Lundër, Tiranë, blerë në shumën 1 157 000 euro, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
19. Pasuri Nr.21/17, Vol.17, Faq.168, ZK Nr.2596, me sipërfaqe totale 700 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë, blerë në shumën 1 157 000 euro, në emër të Shoqërisë "ALESIO - 2014" shpk, me NIPT Nr.L41713003M.
20. Automjet i tipit autoveturë, e markës "Mercedes-Benz", modeli CLS320CDI, me targa TR 5545 T, me numër shasië EDD2193221A113273, në emër të shtetasit Fadil Selman Murati.
21. Automjet i tipit autoveturë, e markës "Mercedes-Benz", modeli G 63 AMG, me targa AA 006 YZ, me numër shasië EDB4632761X327336, në emër të shtetases Radusha Seferin Gjini (bashkëshortja e subjektit nën hetim pasuror).
22. Automjet i tipit autoveturë, e markës "Mercedes-Benz", modeli GLE 400 d 4MATIC Coupé, me targa AB 006 HE, me numër shasië EIN1673231A160131, në emër të shtetasit Klaudia Gjini (vajza e subjektit nën hetim pasuror).



23. Automjet i tipit autoveturë, e markës "VOLKSEAGEN", modeli "GOLF", me targa AA 470 JS, me numër shasje ÈVÈZZZ1KZBÈ006182, në emër të shtetasit Pavlin Kola (bashkëshorti i shtetasës Klaudia Gjini, vajza e subjektit nën hetim pasuror).

IV. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet Znj. Burbuqe Islami, administratore pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Brendshme, Tiranë.


V. Urdhërohet sekretaria Gjyqësore e kësaj Gjykate t'i dërgojë menjëherë 2 (dy) kopje të këtij vendimi prokurorëve, subjektit nën hetim pasuror Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini) dhe personave të lidhur Radusha Gjini, Klaudia Gjini, Pavlin Kola, Fadil Selman Murati si dhe personave juridike.

VI. Kundër vendimit lejohet ankim brenda pesëmbëdhjetë ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar, duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit, të këtij vendimi.


U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.07.2022.

**SEKRETARE**

Burbuqe **ELSA LITA**



**GJYQTARE**

**IRENA GJOKA**  


**GJYQTARE**

**IRENA GJOKA**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

URDHËRI BRENDSHËM

Nr. 2276, Datë 02 / 08 / 2022

**Për emërimin e administratorit për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara.**

Në mbështetje të Ligjit nr. 10192, dt. 3.12.2009 i ndryshuar “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Ligjit nr. 34/2019 “ Për Administrimin e pasurive te sekuestruara dhe te konfiskuara”

URDHËROJ:

- 1- Emërimin e **z. Arjan Baci** si administrator i pasurive te sekuestruara me Vendimin Penal Nr. 22, date 27.02.2022, te Gjykatës se Posacme e Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pasuri te shtetasit Anton (Pashuk) GJINAJ (Gjini).  
Pasurite qe do administrohen sipas dispozitivit te vendimit te mesiperme do jene nga numri rendor 1 deri ne numrin rendor 6.
- 2- Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri administratori **z. Arjan Baci**

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEADMINISTRATOR

**Ardian KONI**

